



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1442/5 prot.

Datë 05.07.2023

V E N D I M
Nr. 568/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.07.2023 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Tower” SHPK në procedurën e prokurimit “*Shërbim konsulence*”, me Nr. REF-64749-04-03-2023, me objekt: “*Supervizion punimesh Plotësimi i punimeve të mbetura në aksin Porto Romano – Durrës Loti 3*”, me fond limit 5.798.242,13 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 16.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Tower” SHPK
Zona Kadastrale 2679, Hyrja 2, AP.39, Kashar, Mëzez,
Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Autoriteti Rrugor Shqiptar
Rruga “Sami Frashëri”, Nr.33, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për*

Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.04.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Shërbim konsulence*”, me Nr. REF-64749-04-03-2023, me objekt: “*Supervizion punimesh Plotësimi i punimeve të mbetura në aksin Porto Romano – Durrës Loti 3*”, me fond limit 5.798.242,13 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 16.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datë 19.04.2023 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (*shprehja e interesit*) nga verifikimi i së cilës rezulton, se kanë shprehur interes operatorët ekonomikë si më poshtë cituar:

1. “Consulting & Management Albania” SHPK
2. “Dricons” SHPK
3. “HTS Company” SHPK
4. “MCE” SHPK

5. "Hydro – ENG Consulting" SHPK
6. "IMES - D" SHPK
7. "GR Albania" SHPK
8. "G B Civil Engineering" SHPK
9. "S & L Studio" SHPK
10. "Zenit & CO" SHPK
11. "Hydrowater - Albania" SHPK
12. "Studio Services D & S" SHPK
13. "Arena MK" SHPK
14. "A.SH Engineering" SHPK
15. "Tower" SHPK

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), rezulton, se në datën 18.05.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën (*short-listing*) duke njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike si më poshtë:

- | | |
|---|--------------|
| 1. "Consulting & Management Albania" SHPK | skualifikuar |
| 2. "Dricons" SHPK | skualifikuar |
| 3. "HTS Company" SHPK | skualifikuar |
| 4. "MCE" SHPK | skualifikuar |
| 5. "Hydro – ENG Consulting" SHPK | skualifikuar |
| 6. "IMES - D" SHPK | skualifikuar |
| 7. "GR Albania" SHPK | skualifikuar |
| 8. "G B Civil Engineering" SHPK | skualifikuar |
| 9. "S & L Studio" SHPK | kualifikuar |
| 10. "Zenit & CO" SHPK | skualifikuar |
| 11. "Hydroëater - Albania" SHPK | skualifikuar |
| 12. "Studio Services D & S" SHPK | skualifikuar |
| 13. "Arena MK" SHPK | skualifikuar |
| 14. "A.SH Engineering" SHPK | skualifikuar |
| 15. "Tower" SHPK | kualifikuar |

II.4. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), rezulton, se në datën 05.06.2023, autoriteti kontraktor ka dërguar "*Ftesë për tender*", duke njoftuar operatorët ekonomikë të kualifikuar në fazën e parë për të paraqitur në fazën e dytë propozimet e tyre më datë 16.06.2023:

- "S & L Studio" SHPK
- "Tower" SHPK

II.5. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), rezulton, se në datën 21.06.2023, autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin e ofertave, ku operatori ekonomik “Tower” SHPK rezulton i skualifikuar me arsyetimin si më poshtë:

Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertës së tyre duhet ti referohen VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe në mbështetje të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017, Nr.5585 Prot “Rekomandim mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016” “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Të gjitha ofertat me vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar dhe me vlerë më të lartë se vlera maksimale e lejuar, sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr.354, datë.11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, do të skualifikohen.

Operatori ekonomik duhet të respektojë legjislacionin në fuqi dhe tarifatat minimale të shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve referuar VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, duke dorëzuar një ofertë të detajuar ekonomike e cila garanton Autoritetin Kontraktor në përmbushjen e termave të referencës.

II.6. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), konkretisht Formularit të Njoftimit të Fituesit (paraparak), rezultojnë se operatorët ekonomikë të kualifikuar janë vlerësuar me pikë si më poshtë:

“S & L Studio” SHPK

Totali i pikëve të marra: **283,20**

“Tower” SHPK

Totali i pikëve të marra: **0**

II.7. Në datën 30.06.2023 është Publikuar Njoftim-Fituesit Paraparak i procedurës së prokurimit objekt-ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.8. Në datën 26.06.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3202, date 23.06.2023 dhe nr. protokollit 1442 datë 26.06.2023 e operatorit ekonomik “Tower” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kundërshtua skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

II.9. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1442/3 prot., datë 27.06.2023 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Tower” SHPK.

II.10. Me shkresën me nr. 5590 prot., datë 29.06.2023, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1442/4 prot., datë 03.07.2023, autoriteti kontraktor ka paraqitur aktin e trajtimit të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Tower” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.11. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit nuk e ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik “Tower” SHPK, për shkak të mosrespektimit të afatit të ankimit të ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, (thema decidendum) në zbatim të nenit 110 “Afatet për ankim”, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në verifikimin e kushteve formale të saj, pra nëse ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues i përmbush kushtet formale të parashikuara në dispozitat ligjore të sipërcituara nga sa më sipër ku një prej të cilave është respektimi i afateve të ankimit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:

III.1.1. Në nenin 46, pikat 2, të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar është parashikuar se:

Llojet e procedurave që duhen përdorur në përzgjedhjen e kontratave të prokurimit publik, janë:

a) procedurë e hapur;

b) procedurë e kufizuar;

c) partneritet për inovacion;

ç) dialogu konkurrues;

d) shërbim konsulence;

dh) procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;

e) procedurë konkurruese me negociim, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave të sektorit klasik;

ë) procedurë me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave sektoriale;

f) procedurë e hapur e thjeshtuar;

g) prokurim me vlerë të vogël.

III.1.2. Në nenin 54, pikat 1, 4, 5 dhe 11 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është parashikuar se:

1. Shërbim konsulence është një procedurë prokurimi me faza, e cila përdoret në rrethanat e parashikuara në nenin 50 të LPP-së, për shërbime të një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese.

4. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 50 të LPP-së. Autoriteti/enti kontraktor mund të përlllogarisë afate më të gjata se afatet minimale të përcaktuara në LPP, kur një gjë e tillë diktohet nga kompleksiteti i objektit të prokurimit apo kërkesave që do duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë.

5. Njoftimi i kontratës për shërbimin e konsulencës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimeve elektronike dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike. Ky njoftim përshkruan nevojat dhe kërkesat e autoritetit/entit kontraktor, karakteristikat e kontratës dhe kriteret minimale të përzgjedhjes së kandidatëve.

Çdo operator i interesuar ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në fazën e parë të kualifikimit, duke dhënë informacionin që kërkohet, nga autoriteti/enti kontraktor.

Autoriteti/enti kontraktor cakton një afat të arsyeshëm për paraqitjen e kërkesës për propozim, por jo më të shkurtër se afatet e parashikuara në nenin 50 të LPP-së.

11. Hapat e procedurës së shërbimit të konsulencës janë:

a) Në fazën e parë të kualifikimit, autoriteti/enti kontraktor përgatit preventivin e kostos dhe buxhetit, të cilat janë pjesë e njoftimit të kontratës. Preventivi i kostos bazohet në vlerësimin që autoriteti ose enti kontraktor u bën burimeve që i nevojiten për të përmbushur detyrën: kostoja për stafin, mbështetja logjistike dhe inputi fizik.

b) Në fazën e dytë, kërkesa për propozime, që u dërgohet kandidatëve të përcaktuar në listën e shkurtër.

III.1.3. Në nenin 110, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, është parashikuar se:

“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

3. Në procedurat e prokurimit me faza mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim.

Në procedurat e prokurimit me faza nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 50 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohet: “1. Shërbim konsulence është një procedurë prokurimi me faza, e cila shërben për prokurimin e kontratave publike për shërbime të një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese. 2. Në procedurat mbi kufirin e lartë monetar, çdo operator ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të njoftimit që përmban informacionin e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik. Afati kohor minimal për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje është jo më pak se 30 ditë nga data në të cilën është publikuar njoftimi i kontratës ose ftesa për shprehje interesi. 3. Në fazën e dytë, ofertë mund të paraqesin vetëm kandidatët e përzgjedhur nga autoriteti kontraktor. Afati minimal për pranimin e ofertave është jo më pak se 30 ditë, nga data në të cilën është publikuar ftesa për ofertë.”. Ndërsa në formularin e njoftimit të fituesit, i cili është formular standard i miratuar nga Agjencia e

Prokurimit Publik dhe është i përfshirë në dokumentet standarde të tenderit, përcaktohet: *“Me marrjen/publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.*

III.1.5. Komisioni gjykon të ndalet dhe të analizojë, përcaktimet ligjore në fuqi për prokurimin publik lidhur me ankimet në procedurat e prokurimit, si dhe afatet për paraqitjen e tyre. Komisioni sjell në vëmendje, se legjislacioni në fuqi për prokurimin publik parashikon kryerjen e *procedurave të prokurimit me një fazë*, ku ofertuesit *paraqesin njëkohësisht dokumentacionin e nevojshëm (për të vërtetuar se përmbushin kriteret e kualifikimit) dhe ofertën ekonomike*, për të cilat autoriteti kontraktor kryen vetëm një proces vlerësimi e më pas shpall fituesin e kontratës ose me *disa faza* ku paraprakisht operatorët ekonomikë të interesuar, në cilësinë e kandidatit, *paraqesin kërkesat për pjesëmarrje dhe dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar se përmbushin kriteret e kualifikimit dhe në rast se kualifikohen/përzgjidhen*, dhe ftohen nga autoriteti kontraktor për të paraqitur ofertat teknike dhe ekonomike në varësi të procedurës konkrete. Në procedurat e prokurimit me *disa faza*, autoriteti kontraktor është i detyruar që për çdo fazë të bëjë vlerësimin përkatës, ku në fazën e parë vlerëson kërkesat për pjesëmarrje dhe dokumentacionin i nevojshëm (për të vërtetuar se kandidatët përmbushin kriteret e kualifikimit) e më pas në fazat e tjera vlerëson ofertat teknike dhe ekonomike vetëm të operatorëve ekonomikë të cilët janë ftuar (pasi janë kualifikuar) nga autoriteti kontraktor për të paraqitur ofertë. Gjithashtu, Komisioni vëren, se ligjvënësi ka parashikuar mundësinë e ankimit në disa raste dhe momente procedurale të procedurës së prokurimit, ku ndër të tjera, dy prej tyre janë *ankimi për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar sipas pikës 2 të nenit 110 të LPP-së dhe ankimi për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit në procedurat me faza sipas pikës 3 të nenit 110*. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se ligjvënësi ka bërë një ndarje lidhur me momentin procedural të nisjes së afateve të ankimit vetëm mbi vendimmarrjen e autoritetit kontraktor për kualifikimin/përzgjedhjen e kandidatëve në fazën e parë të procedurës së prokurimit, pasi vetëm në këtë rast operatorët ekonomikë mund të ankohen për këtë vendim brenda 10 ditëve nga momenti i marrjes dijani për të në rastet e kontratave me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, si dhe 7 ditëve nga momenti i marrjes dijani për të në rastet e kontratave me vlerë nën kufirin e lartë monetar.

III.1.6. Në rastin konkret, Komisioni vëren, se operatori ekonomik ankimues *“Tower” SHPK*, ka paraqitur ankesë duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij pas vlerësimit me pikë të propozimeve të paraqitura prej tij.

Sa më sipër, Komisioni gjykon, se jemi në kushtet ankimit lidhur me fazën e dytë të procedurës së prokurimit dhe që lidhet me vlerësimin e ofertave, e për rrjedhojë *afatet e ankimit lidhur me këtë fazë të procedurës fillojnë nga momenti i njoftimit të fituesit sipas pikës 2 nenit 110 të LPP-së dhe jo nga marrja dijani mbi vendimin sipas pikës 3 të nenit 110 të LPP-së*. Komisioni sqaron, se ligjvënësi e ka ndarë qartë vlerësimin lidhur me kërkesat për pjesëmarrje dhe vlerësimin e ofertave, sikurse ka ndarë statusin e kandidatit në fazën e parë të procedurës nga statusi i ofertuesit në fazën e dytë të procedurës.

III.1.7. Komisioni gjykon të ndalet dhe të analizojë, përcaktimet ligjore në fuqi për prokurimin publik lidhur me ankimet në procedurat e prokurimit, si dhe afatet për paraqitjen e tyre.

Komisioni sjell në vëmendje se legjislacioni në fuqi për prokurimin publik parashikon kryerjen e procedurave të prokurimit me një fazë, ku ofertuesit paraqesin njëkohësisht dokumentacionin e nevojshëm (për të vërtetuar se përmbushin kriteret e kualifikimit) dhe ofertën ekonomike, për të cilat autoriteti kontraktor kryen vetëm një proces vlerësimi e më pas shpall fituesin e kontratës ose me disa faza ku paraprakisht operatorët ekonomikë të interesuar, në cilësinë e kandidatit, paraqesin kërkesat për pjesëmarrje dhe dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar se përmbushin kriteret e kualifikimit dhe në rast se kualifikohen/përzgjidhen, ftohen nga autoriteti kontraktor për të paraqitur ofertat teknike dhe ekonomike në varësi të procedurës konkrete. Në procedurat e prokurimit me disa faza, autoriteti kontraktor është i detyruar që për çdo fazë të bëjë vlerësimin përkatës, ku në fazën e parë vlerëson kërkesat për pjesëmarrje dhe dokumentacionin e nevojshëm (për të vërtetuar se kandidatët përmbushin kriteret e kualifikimit) e më pas në fazat e tjera vlerëson ofertat teknike dhe ekonomike vetëm të operatorëve ekonomikë të cilët janë ftuar (pasi janë kualifikuar) nga autoriteti kontraktor për të paraqitur ofertë. Gjithashtu, Komisioni vëren, se ligjvënësi ka parashikuar mundësinë e ankimimit në disa raste dhe momente procedurale të procedurës së prokurimit, ku ndër të tjera, dy prej tyre janë ankimi për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar sipas pikës 2 të nenit 110 të LPP-së dhe ankimi për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit në procedurat me faza sipas pikës 3 të nenit 110. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se ligjvënësi ka bërë një ndarje lidhur me momentin procedural të nisjes së afateve të ankimit vetëm mbi vendimmarrjen e autoritetit kontraktor për kualifikimin/përzgjedhjen e kandidatëve në fazën e parë të procedurës së prokurimit, pasi vetëm në këtë rast operatorët ekonomikë mund të ankohen për këtë vendim brenda 10 ditëve nga momenti i marrjes dijeni për të në rastet e kontratave me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, si dhe 7 ditëve nga momenti i marrjes dijeni për të në rastet e kontratave me vlerë nën kufirin e lartë monetar.

Bazuar në përcaktimet sipërcituara, si dhe bazuar në parashikimet ligjore në fuqi për prokurimin publik, Komisioni gjykon se në rastin konkret, përlllogaritja e afatit për të paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, nis nga dita e publikimit të njoftimit fituesit ose njoftimit të anulimit të procedurës së prokurimit dhe përfundon ditën e 7 (shtatë). Në rastin konkret, referuar verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimit Elektronik, rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor, deri në datën e paraqitjes së ankesës, nuk është publikuar në SPE njoftimi i fituesit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, moment procedural nga i cili fillon afati i ankimit për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, ndërkohë që operatori ekonomik ankimues “*Tower*” SHPK ka dorëzuar ankesë për vlerësimin me pikë të procedurës së mësipërme të prokurimit, pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në datën 26.06.2023. Ndërkohë që nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se në datën 30.06.2023 autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim Fituesin Paraparak për procedurën e prokurimit objekt-ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, në të cilin përcaktohet, se me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit, përlllogaritja e afateve për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, do të nisë nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit paraparak në Sistemin Elektronik të Prokurimeve, për të cilin, referuar Manualit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 1, datë 24.12.2021 “*Për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit*

elektronik”, miratuar me Vendimin Nr. 13, datë 28.12.2021, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, njoftohen automatikisht nga SPE.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kundër vendimeve të autoritetit kontraktor lidhur me vlerësimin e procedurës së prokurimit, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit paraprak ose publikimit të njoftimit të anulimit dhe përfundon në ditën e 10-të për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe në ditën e 7-të për procedurat nën kufirin e lartë monetar. Në rastin konkret, llogaritja e afateve për paraqitjen e ankesës në datë 26.06.2023 si pranë autoritetit kontraktor ashtu dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nuk kishte filluar ende, për sa kohë që publikimi i njoftim fituesit paraprak të procedurës së prokurimit objekt ankimi është publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike më datë 30.06.2023, që do të thotë se operatorit ekonomik ankimues nuk i ka lindur ende e drejta e ankimit, pasi ligjvënësi momentin procedural të ankimit e lidh me momentin procedural të publikimit të njoftim-fituesit paraprak. Për sa më sipër, ankesa e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor më datë 26.06.2023, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor, ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

III.1.8. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomikë ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Tower” SHPK për procedurën e prokurimit “*Shërbim konsulence*”, me Nr. REF-64749-04-03-2023, me objekt: “*Supervizion punimesh Plotësimi i punimeve të mbetura në aksin Porto Romano – Durrës Loti 3*”, me fond limit 5.798.242,13 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 16.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “Tower” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

